



VENDIM

Nr. 7 Date 26.1. 2009

MBI

**SHTYRJEN E AFATIT TE ZBATIMIT TE TARIFAVE TE SHERBIMIT
DHE ÇMIMEVE TE SHITJES ME PAKICE DHE SHUMICE TE
ENERGJISE ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, VKM nr.27 date 19.01.2007 “ Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe te dhenies se koncensioneve” i ndryshuar, Vendimit te Bordit të Komisionerëve Nr. 87, date 06.08.2008 “Per miratimin e deklarates rregullatore ne kuader te zbatimit te metodologjive te llogaritjes se tarifave te energjise elektrike”, te ndryshuar, Bordi i Komisionereve te Entit Rregullator te Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 26.01.2009, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorise se Tarifave dhe Çmimeve lidhur me shtyrjen e afatit te zbatimit te tarifave te sherbimit te energjise elektrike, te çmimeve te shitjes me pakice te energjise elektrike per konsumatorët tarifore, te çmimit te shitjes se energjise elektrike te prodhuar nga HEC-et ekzistues (private apo te dhene me koncension) me fuqi te instaluar deri ne 10 MW dhe te cmimit te shitjes se energjise elektrike te prodhuar nga HEC-et te rinj me fuqi te instaluar deri ne 15 MW.

Konstatoi se:

- Ligji nr.9072 date 22.05.2003 “ Per sektorin e energjise elektrike” i ndryshuar, percakton ERE-n, ne cilesine e autoritetit pergjegjes per vendosjen e tarifave te energjise elektrike per te gjithë veprimtarite e rregulluara.
- Me Vendimin nr. 87, date 06.08.2008 “Per miratimin e deklarates rregullatore ne kuader te zbatimit te metodologjive te llogaritjes se tarifave te energjise elektrike”, te ndryshuar, Bordi nder te tjera ka vendosur ngrirjen e tarifave dhe çmimeve te shitjes se energjise elektrike,
- Me vendimin nr.87, date 16.01.2008 “ Per disa shtesa dhe ndryshime ne VKM nr.27 date 19.01.2007 “Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe te dhenies se koncensioneve” i ndryshuar, Keshilli i Ministrave nder te tjera ka shtuar fuqine e instaluar nga 10 MW ne 15 MW per HEC e rinj,

Per gjithë sa me siper cituar Bordi i Komisionereve te ERE-s

Vendosi:



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve



1. Te shtyhet afati i zbatimit te tarifave te sherbimit te energjise elektrike, te çmimeve te shitjes me pakice te energjise elektrike per konsumatorët tarifore, te çmimit te shitjes se energjise elektrike te prodhuar nga HEC-et ekzistues (private apo te dhene me konçension) me fuqi te instaluar deri ne 10 MW dhe te cmimit te shitjes se energjise elektrike te prodhuar nga HEC-et te rinj me fuqi te instaluar deri ne 15 MW.

- 2- Lenien ne fuqi deri me date 31.12.2009 te vendimeve te Bordit te Komisionereve, si me poshte:
 - Vendimi nr. 82, date 24.12. 2007 “Per percaktimin e shitjes se energjise elektrike nga HEC-et e rinj me fuqi te instaluar deri ne 10 MW per vitin 2008”;
 - Vendimi Nr. 18, date 14.02. 2008 “Per percaktimin e tarifes se prodhimit te energjise elektrike nga KESH sha per periudhen 1 Mars 2008- 28.Shkurt 2009”;
 - Vendimi Nr. 19, date 14.02. 2008 “Per percaktimin e tarifes se sherbimit te transmetimit te energjise elektrike nga OST sha per periudhen 1 Mars 2008-28.Shkurt 2009”;
 - Vendimi Nr. 20, date 14. 02. 2008 “Per percaktimin e tarifes se sherbimit te shpendarjes se energjise elektrike per perdoruesit e sistemit te shpendarjes, per periudhen 1 Mars 2008- 28 Shkurt 2009”;
 - Vendimi Nr. 21, date 14.02. 2008 “Per percaktimin e çmimit te shitjes me pakice per konsumatorët tarifore per periudhen 1 Mars.2008- 28 Shkurt 2009”;
 - Vendimi Nr. 22, date 14.02.2008 “Per percaktimin e cmimit te shitjes se energjise elektrike per te licensuarit per prodhimin e energjise elektrike nga hidrocentralet me fuqi te instaluar deri ne 10 MW per periudhen 1 Mars. 2008- 28 Shkurt 2009”;
 - Vendimi Nr. 75, date 26.06.2008 “Per percaktimin e çmimit te shitjes me shumice te energjise elektrike nga FPSH per periudhen 1 Korrik 2008 – 28 Shkurt 2009”.

- 3- Efektet e shkaktuara nga lenia ne fuqi e vendimeve te mesiperme, per te gjithë perberesit e çmimit te shitjes me pakice te energjise elektrike, do te kompensohen ne çmimet dhe tarifat e sherbimeve te energjise elektrike per vitin 2010.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

Ky vendim botohet ne Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIMIN
Nr. 7 date 26.1.2009

MBI
SHTYRJEN E AFATIT TE ZBATIMIT TE TARIFAVE TE SHERBIMIT
DHE ÇMIMEVE TE SHITJES ME PAKICE DHE SHUMICE TE
ENERGJISE ELEKTRIKE

Anëtarët e Bordit

| | Pro | Kundër |
|-------------------|-------|--------|
| Bujar Nepravishta | _____ | _____ |
| Entela Shehaj | _____ | _____ |
| Ardian Haçi | _____ | _____ |
| Abaz Aliko | _____ | _____ |